


TRIBUNA SINDIKALE

Dhjetor 2012

*Dhe ditë e diturisë
përpara do na shpjerë*



100 VJET PAVARËSI



Editorial

MESUESI DHE SHKOLLA – BINOMI VEPRIMTARISE SINDIKALE TE FSASH/SPASH

Mesuesi, kujdesi per vleresimin e figures dhe te profesionit te tij si mesimdhene dhe edukator, mbrojtja e interesave ne fushen e punesimit dhe te kerkesave ekonomike e sociale, rritja e profesionalizmit, te gjitha keto, te lidhura ngusht me synimin dhe objektivat konkrete per nje shkollë te reformuar, te afte qe te ofroje sherbim dhe arsimim cilesor ne funksion te pergatitjes se brezave te ardhshem si qytetare e atdhetare te denje, te paisur me dije te thella kulturore e shkencore, mbrojtjes te idealeve te lirise dhe demokracise; kane qene dhe mbeten ne qender te vemendjes dhe veprimtarise sindikale te SPASH/FSASH.

Veprimtarite sindikale te zhvilluara gjate vitit 2012 jane vertetim i plote dhe i qarte i orientimit te drejte bashkekohor te levizjes sindikale ne arsim, qe perbehet nga koalicioni tashme i konsoliduar FSASH/SPASH.

Midis veprimtarive te shumta te zhvilluara gjate ketij viti, po vechojme vetem procesin e diskutimit dhe miratimit te Ligjit te ri “Per Sistemin Arsimor Parauniversitar ne Republiken e Shqiperise”. Sindikatat e Arsimit u angazhuan aktivisht ne nje dialog te vertete dhe frytdhene ne te gjitha etapat e diskutimit te draft-ligjit te ri, parashtruan me objektivitete dhe realizem kerkesat dhe opsionet e tyre per statusin e personelit mesimdhene, per vleresimin e figures se mesuesit, per permiresimin e pozites se tyre ekonomike e sociale, per garantimin ligjor te vendit te punes, dhe i mbrojtjen pikepamjet dhe kerkesat e tyre ne negociimet e zhvilluara me MASH, me kerkesat drejtuar Qeverise dhe para Komisioneve te Perhershme Parlamentare.

Kjo beri te mundur qe, edhe ne saj te kontributit te sindikatave, te kemi sot nje Ligj bashkekohor, te miratuar me konsensusin e te gjithë forcave politike qe perfaqesohen ne Parlament dhe qe perben bazen juridike te orientimit dhe zhvillimit bashkekohor te sistemit arsimor parauniversitar ne vendin tone.

Por, nese fokusi i politikave dhe veprimtarive sindikale te SPASH/FSASH ka qene dhe mbetet **kujdesi per mesuesin dhe shkollen si nje detyrim i tyre programor dhe statutor**, si nje angazhim i

strukturave sindikale ne qender e ne baze ne menyre te perhershme, sidomos per mbrojtjen e kerkesave dhe interesave sociale ekonomike te sindikalisteve dhe mesuesve, atehere **natyrshem shtrohet pyetja dhe kerkesa:**

Cili duhet te jete qendrimi i cdo mesuesi ndaj sindikatave?

Koalicioni apo Aleanca sindikale midis FSASH/SPASH kane te anetarsuar ne gjirin e tyre masen me te madhe te mesuesve te sistemit te arsimit parauniversitar. Ne te dy sindikatat se bashku jane te anetaresuar me dokumentacion te rregullt anetaresie dhe me kuotizacion mbi 80 perqind e personelit te ketij sistemi. Natyrisht kjo anetaresi perben forcen e padiskutueshme te sindikatave tona dhe garancine e zbatimit nga ana e tyre te vizionit, synimeve dhe objektiveve te percaktuara.

Objektivi i FSASH/SPASH per vitin 2013 eshte anetaresimi ne sindikate i te gjithë mesuesve, vecanerisht i mesuesve te rinj, sepse ne kushtet e institucionalizimit te marredhenieve te punes, nepermjet Kontrates Kolektive te nenshkruar nga te dy sindikatat me MASH, eshte ne interesin e tyre anetaresimi ne sindikate.

Thirrja jone per vitin 2013 drejtuar mases se sindikalisteve te bazes dhe gjithë mesuesve eshte: **Bashkohuni fort rreth koalicionit sindikal FSASH/SPASH, anetarsohuni ne sindikate, merrni pjese aktive ne levizjet dhe veprimtarite sindikale, njihuni nepermjet faqeve te “ Tribunes Sindikale”, faqes se internetit, seminareve trajnuese, veprimtarive ne baze, me punen qe bejne sindikatat qendrore dhe strukturat e tyre, sidomos ne procesin e dialogut social me punedhenezin, me kerkesat qe shtrajne dhe zgjidhjet qe arrijne, dhe ndihmoni me verejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja, ne interesin tuaj, ne interesin e te gjithë mesuesve, qe forca argumentuese dhe realizuese e sindikatave t’i sherbeje edhe me mire mbrojtjes se interesave sociale- ekonomike te mesuesve dhe mbarevajtjes se shkolles.**

PERMBAJTJA

- ✓ Editorial
Mesuesi dhe shkolla – Binomi i veprimtarise sindikale te FSASH/SPASH **2**
- ✓ Kushtet dhe kriteret ligjore per te fituar dhe ushtruar profesionin e mesuesit **3**
- ✓ Te thellojme me tej arritjet e vitit 2012, (Nga mbledhja e KK te SPASH) **4**
- ✓ 2013 – Viti i Kongresit te 5-te te FSASH, (Nga mbledhja e KD te FSASH) **5**
- ✓ Aktivitete me rastin e 100 Vjetorit te Pavaresise **6**
- ✓ Nxenesit braktises kthehen ne shkolle
- ✓ Protesta e popullit te Kosoves qe sfidoi regjimin barbar serb **8**
- ✓ Ligji per Arsimin dhe Formimin Profesional ne Republiken e Shqiperise **9**
- ✓ Donacioni i Cmimit te AOb, Gelder, per dy shkollat e Korces **15**

*Kopertina e pare dhe e fundit:
Nga festimet per 100 Vjetorin e
Pavaresise.*

**TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 45
Dhjetor 2012**

Botim i FSASH dhe SPASH

ADRESA:
Rruga “Dora D’Istria”,
Pallati Perballe Fakultetit Juridik,
Tirane

Tel & Fax + 355 4 2 25 65 32
Celular: + 355 68 20 34 674,
+ 355 69 22 69 795,
+ 355 68 21 52 891

E-mail: fsash@icc-al.org
Internet: www.fsash-spash.com

Te njohim Ligjin per Sistemin Arsimor Parauniversitar

KUSHTET DHE KRITERET LIGJORE PER TE FITUAR DHE USHTRUAR PROFESIONIN E MESUESIT

Xhafer Dobrush, Kryetar i FSASH

Miratimi nga Parlamenti i Ligjit “**Per Sistemin Arsimor Parauniversitar ne Republikën e Shqiperise**”, ne qershor 2012, eshte nje nga arritjet me te shenuara, jo vetem per mesuesit, nxenesit dhe prinderit, por edhe per te gjithë shqiptaret, sepse teresia e dispozitave qe permban Ligji i ri, ne pergjithesi, u jep forme dhe force ligjore standardeve te sotme bashkekohore qe mundesojne nje arsim cilesor dhe shanse te barabarta per te gjithë, si kushti me themelor per zhvillimin dhe progresin e panderprere ekonomik dhe shoqeror te vendit, si pjese e familjes europiane.

Procesi i diskutimit te Ligjit, qe zgjati pothuajse nje vit, perfshiu ne debat nje rreth te gjere partneresh, institucione, organizata, dhe shoqata te shoqerise civile, mesues, nxenes dhe prinder. Si rezultat, u mundesua permiresimi rrenjesor i draftit dhe u arrit miratimi i tij me konsensus ne komisionet parlamentare dhe ne seancen plenare te Kuvendit.

Sindikatat e Arsimit, FSASH/SPASH, si partneret social ligjor te Ministrise se Arsimit dhe Shkences, u perfshine, me gjithë potencialin e tyre, ne cdo etape te diskutimit te draft-ligjit te ri. Ne menyre te vecante, sindikatat parashtruan opsionet e tyre per statusin e personelit mesimor, per figuren dhe misionin e mesuesit, per standardet qe kerkon ushtrimi i profesionit te mesuesit, per kriteret ligjore te punesimit te tyre ne arsim, etj. Propozimet dhe kerkesat kembengulese te sindikatave **per dispozitat qe percaktonin statusin e personelit mesimor**, ne thelb, mbeshteteshin ne institucionalizimin e marredhenieve punedhenes - punemarres ne sektorin e arsimit, te arritur gjate dy dekadave dhe te pasqyruar ne Kontratat Kolektive te Punes te nivelit te pare, te nenshkruara nga te dy partneret ne menyre periodike sipas standardeve dhe kerkesave te Konventave Nderkombetare dhe Kodit te Punes te Republikës se Shqiperise, duke garantuar “de jure”, nje mbrojtje te konsoliduar ekonomike e

sociale te mesuesve dhe punonjesve te tjere te sektorit te arsimit.

Mbeshtetur ne arritjet e derisotme dhe ne kerkesat e standardet bashkekohore europiane per nje arsim cilesor dhe krijim shansesh te barabarta per te gjithë ne procesin e arsimimit, u arrit, me konsensus midis punedhenesit dhe sindikatave ne rolin e punemarresit, hartimi i dispozitave qe permbledhen ne kreun e IX te Ligjit te ri.

Mbas miratimit te Ligjit, sindikatat kane terhequr vemendjen e strukturave kombetare e lokale te tyre, te sindikalisteve dhe gjithë mesuesve per nevojen e njohjes se dispozitave te Ligjit, si kusht per zbatimin e drejte te tij ne jeten e perditshme, per arritjen e objektiveve qe Ligji synon ne fushen e arsimit dhe arsimimit.

Ne kete koment ne do te ndalemi vetem ne dy dispozita te ligjit, pikerisht ne kuptimin dhe zbatimin e **Nenit 57 “Profesioni i mesuesit” dhe pika 5 e Nenit 72 “Dispozitat e fundit dhe kalimtare”**

Ne Nenin 57-te, “Profesioni i mesuesit”, ligjvenesit ka percaktuar kriteret profesionale qe duhen permbushur per te ushtruar profesionin e mesuesise. Ne piken 1, shkronja “a” dhe “b” dhe ne pikat 2,3 kjo dispozite permban nivelin e diplomave sipas ciklit te studimeve universitare te vlefshme per te dhene mesim ne secilin ciklet te arsimit parauniversitar.

Ne piken 4 te Nenit 57 thuhet: “Mesuesi i arsimit fillor dhe i arsimit te mesem ka te drejten e ushtrimit te profesionit te mesuesit pasi te kete kryer me sukses praktiken profesionale dhe te kete kaluar ne provimin e shtetit, sic parashikohet ne Ligjin Nr.10171 date 21.10.2009 “Per profesionet e rregulluara ne Republikën e Shqiperise”, te ndryshuar, dhe aktet nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij”.

Krahasuar me piken 5 te Nenit 72 te ligjit, “Dispozitat e fundit dhe kalimtare” behet e qarte se ne rastin e pikes 4 te Nenit 57 kemi te bejme me nje **dispozite qe vepron ne menyre te kufizuar dhe te**

kushtezuar. Me konkretisht: standardi qe ligjvenesit percakton ne piken 4 te Nenit 57 **eshte i detyrueshem** vetem per ata qe mbarojne studimet universitare per mesuesi ne vitin akademik 2011/2012, ose edhe me pare, por **qe ne momentin e miratimit te Ligjit nuk jane te punesuar me kontrate te perhereshme** ne nje nga ciklet e arsimit parauniversitar, sipas standardeve qe jane percaktuar ne Kontraten Kolektive te Punes te nivelit te pare, date 25 maj 2010 dhe te Akteve adekuate perkatese te nxjerra nga Ministri i Arsimit dhe Shkences.

Pikerisht ne kufizimin dhe kushtezimin e pikes 4 te Nenit 57 me piken 5 te Nenit 72 te Ligjit te arsimit parauniversitar qendron nje nga arritjet me te medha te sindikatave ne procesin e diskutimit te Ligjit te ri, per mbrojtjen e vendit te punes te rreth 35 mije sindikalisteve dhe mesuesve te punesuar me kontrate te perhereshme, nje pjese e madhe e te cileve perbejne aktualisht dhe per shume kohe ne te ardhmen, boshtin e kontigjentit mesimdhene cilesor, qe ofron sot shkolla jone, perbejne garancine per plotesimin ne te ardhmen te standardeve bashkekohore qe kerkon Ligji i ri. Mbi kete logjike, punuan te dy partneret, me kete logjike u diskutua ne komisionet e perhereshme parlamentare, deri sa u arrit ne formulimin dhe pranimin nga ligjvenesit te pikes 5 te Nenit 72.

Po cfare permban pika 5 e Nenit 72? **“Personeli mesimdhene**, thuhet ne kete dispozite, **qe eshte i punesuar me kontrate te perhereshme dhe ka formimin perkatese universitar, ruan vendet e punes dhe u nenshtrohet trajnimeve per perditshimin e dijeve qe lidhen me profesionin. Ky percaktim vlen edhe per mesuesit qe kane perfunduar arsimin e larte pedagogjik 3 vjecar, perpara hyrjes ne fuqi te sistemit te Bolonjes”**.

Personeli mesimdhene, qe eshte i punesuar me kontrate te perhereshme dhe qe ka mbaruar nje shkollë te mesme pedagogjike, ose shkollë tjetër te

Vijon në faqen 4

Vijon nga faqja 3

profilizuar per mesuesi, sic jane shkollat e mesme te muzikes, artistike, te gjuheve te huaja dhe fizkultures, dhe qe kane fituar tri shkallet e kualifikimit, ruan vendet e punes dhe u nenshtrohet trajnimeve per perditesimin e dijeve qe lidhen me profesionin". (Neni 72, pika 5 e Ligjit nr. 69/2012 date 21.6.2012 " Per Sistemin Arsimor Parauniversitar ne Republiken e Shqiperise").

Duke e vene theksin ne nevojen e domosdoshme te njohjes nga cdo sindikalist dhe mesues te Ligjit te ri per sistemin arsimor parauniversitar, sidomos te dispozitave te neneve 57 dhe 72, ne duam te terheqim vemendjen e tyre dhe t'i mbrojme ata nga disa spekulime qe po behen ne kurriz te tyre, tani per tani nga persona qe mbeten "anonime", por qe ne te vertete, jane nga radhet e drejtuesve te disa shkollave, apo edhe te ndonje DAR/ZA-je, qe ndonese ne heshtje, gjoja me "qellimin e mire" per te rritur shkallen e kualifikimit te personelit, i trembin mesuesit qe jane te punesuar me kontrate te

perhershme, duke u thene se per te ruajtur vendin e punes duhet te regjistrohen per te mbrojtur masterin e shkalles se pare apo te dyte dhe te paguajne per kete ne institucionet e licensuara qe ofrojne studime per master, qofshin private apo publike.

Interesi i ketyre institucioneve eshte qe ne studimet per master te terheqin masen e madhe prej dhjetra mije mesuesish, nga xhepat e te cileve do te perfitojne disa miliona Euro. Eshte e kuptueshme se perfitim do te kene edhe ata drejtues qe kete mase te madhe mesuesish i "orientojne", pa qene nevoja, per te mos thene i kercojne per te kryer studimet per master, kur ne Ligji thuhet qarte se kjo kategori mesuesish do te kualifikohen nepermjet perditesimit te njohurive qe lidhen me profesionin e tyre.

Por ne keto raste demi qe paguajne mesuesit nuk eshte vetem material. Pra kategoria e mesuesve qe ne momentin e miratimit te Ligjit kane qene te punesuar me kontrate te perhershme, nese regjistrohen e paguajne dhe mbarojne

studimet per master, qofte edhe me vullnetin e tyre, sipas Ligjit per profesionet e rregulluara, keta do t'i nenshtrohen detyrimisht provimit te shtetit per t'u licensuar rishtas per te ushtruar profesionin e mesuesit. Kuptohet qe mesuesi i cili nuk arrin ta marre kete provim, humb vendin e punes. Ne kete rast, humb edhe mundesine e cdo mbrojtjeje sindikale apo gjyqesore.

Duke terhequr vemendjen dhe shfaqur nje shqetesim real per pasojat qe mund t'u vijne sindikalisteve dhe mesuesve nga moskuptimi dhe moszbatimi drejte i dispozitave te neneve 57 dhe 72 te Ligjit te ri te sistemit te arsimit parauniversitar, ne kuresesi nuk duam te zebhim kerkesen imperative qe sot qendron para cdo mesuesi per rritjen e panderprere te njohurive dhe te kualifikimit, qe lidhen me profesionin; per te ecur me kohen, nepermjet punes kerkimore dhe studimeve te pavarura, dhe nepermjet programeve qe perpunon dhe zbaton cdo vit vete shkolla, njesite vendore arsimore dhe Ministria e Arsimit dhe Shkences.

Te thellojme me tej arritjet e vitit 2012

(Nga mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH)

Ne daten 14 dhjetor 2012, ne sallën e mbledhjeve te Keshillit Kombetar dhe te seminareve te BSPSH-se, u zhvillua mbledhja e radhes e Keshillit Kombetar te SPASH.

Ne kete mbledhje u be Analiza vjetore e punes dhe veprimtarise se SPASH dhe u diskutuan probleme te ndryshme qe kane dale gjate vitit 2012, si edhe disa nga detyrat kryesore per vitin 2013.

Ne mbledhje ishte i ftuar dhe mori pjese edhe Presidenti i BSPSH-se Zoti Gezim Kalaja.

Materialin kryesor, ne emer te Kryesise, e mbajti Presidenti i SPASH-it, Zoti Bajram Kruja, i cili, nder te tjera, theksoi:

Nga kater mbledhje te Keshillit Kombetar dhe gjashte te Komitetit Ekzekutiv te planifikuar, jane zhvilluar pese mbledhje te Keshillit Kombetar dhe kater te Komitetit Ekzekutiv. Tre nga mbledhjet e Keshillit Kombetar, veç trajtimit tematik te planifikuar qe ne fillim te vitit, kane patur edhe karakter seminari, me qellim qe t'i sherbenin permiresimit te punes se drejtuesve te rinj te disa rretheve, dhe dy takimet e tjera kane qene me karakter njohjeje dhe ekskursioni, njeri prej te cileve u zhvillua jashte vendit, ne Selanik, Stamboll e Sofje,

dhe tjetri ne Vlore, ne kuadrin e 100-Vjetorit te Pavaresise.

Gjithashtu, Zoti Kruja nenvizoi nivelin e mire te partneritetit e dialogut social me Ministrine e Arsimit e Shkences, MASH, dhe me pjesen me te madhe te DAR e Za-ve

Per kete, SPASH ka botuar dhe shperndare ne te gjitha SPA-te e rretheve: 2 500 statute me kontrate, 15 000 kopje te kontrates kolektive, 2 000 kopje Revista "Tribuna Sindikale", si edhe ka blere komplet kompjutera per te gjitha ato rrethe



te rretheve dhe kerkoi ngritjen ne kete nivel edhe ne disa rrethe te tjera ku ky partneritet nuk funksionon sic duhet, si ne Fier, Berat, Gjirokaster, Durres, Tepelene, si dhe permiresimin e tij ne nivel shkollë, mbeshtetur ne Kontraten Kolektive te Punes.

që, sipas kontrates kolektive, kane marre zyra pune nga DAR-ZA ose kane zyra te perbashketa me BSPSH etj.

Gjithashtu, ai vleresoi partneritetin e mire me BSPSH-ne, FSASH-in, SBASHK-un e Kosoves dhe organizmat nderkombetare ku

Vijon në faqen 5

2013 - VITI I KONGRESIT TE 5-te TE FSASH

Nga mbledhja e Keshillit Drejtues te FSASH

Me 21 dhjetor 2012, Keshilli Drejtues i FSASH, zhvilloi mbledhjen e tij te fundit per kete vit. Keshilli, duke mbajtur parasysh zhvillimet qe kane ndodhur dhe po ndodhin ne levizjen sindikale ne vend, orvatjet spekulative dhe mashtruese te disa te vetquajturish sindikaliste, apo persona te tjere anonime, te cilet nuk punojne ne sistemin e arsimit dhe nuk kane asnje lidhje apo marrëdhënie institucionale me kete sistem, nisur nga nevoja per ta forcuar dhe konsoliduar me tej levizjen sindikale ne kuader te FSASH dhe per te mbrojtur interesat e kesaj levizjeje, vendosi ta shpalle vitin 2013, **vit te veprimtarive masive, te analizave te thella sindikale, llogaridhenese, zgjedhore ne te gjithë strukturat e FSASH, vit te rritjes se metejshme te forces realizuese sindikale ne arsim, duke i kurorëzuar keto veprimtari me Kongresin e 5-te te FSASH.**

Ne fjalen hyrese, Kryetari i FSASH Z. Xhafer Dobrushu, vuri theksin ne angazhimet e te gjithë strukturave sindikale te Federates gjate vitit 2012, per forcimin organizativ te keshillave dhe seksioneve sindikale, rritjen e anetaresise me kuotizacion, organizimin e veprimtarive kulturore dhe shlodhese, trajnimin sindikal, angazhimin ne punen per minimizimin e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe perballjen me sfidat e vazhdueshme te dialogut social.

Kjo mbledhje e Keshillit Drejtues, theksoi Z. Dobrushu, nuk ka per objekt analizen teresore te veprimtarise se vitit 2012, por synon qe, nepermjet diskutimeve dhe terheqjes se vemendjes ne disa arritje dhe probleme thelbesore, te pergatise

analizen e plote dhe programin per vitin 2013, qe do te diskutohet e miratohet ne mbledhjen e ardhshme.

Nga fjala hyrese e Kryetarit te FSASH dhe diskutimet e shumta te anetaresive te Keshillit, u evidentuan arritjet ne funksionimin e strukturave te bazes. Keshtu, me rendesi te vecante u konsiderua ristrukturimi i keshillave dhe seksioneve sindikale ne rrethe te rendesishme si Korca, Lushnja, Tirana Qark, Librazhdi dhe Peqini. Por sfida me e madhe e vitit ka qene angazhimi i FSASH ne diskutimin e draft-ligjit "Per sistemin Arsimor Parauniversitar ne Republikën e Shqiperise". Ne te gjitha etapat dhe nivelet e diskutimit me MASH, Qeverine dhe Komisionet Parlamentare, lidhshipi i FSASH shtroi opsione dhe kerkesa te bazuara dhe argumentuara, qe jo vetem permiresuan cilesine e vete Ligjit, por edhe garantuan nje mbrojtje sociale teper jetike per sindikalistet dhe gjithë masen e mesuesve te sistemit parauniversitar.

Ne fund, Keshilli Drejtues i FSASH, njezëri, miratoi Vendimin qe vijon:

V E N D I M

I KESHILLIT DREJTUES TE FEDERATES SE SINDIKATAVE TE ARSIMIT DHE SHKENCES

Keshilli Drejtues i FSASH, ne mbledhjen e tij te dates 21dhjetor 2012, duke mbajtur parasysh zhvillimet qe kane ndodhur dhe po ndodhin ne levizjen sindikale ne vend, nisur nga nevoja per te marre vendime te rendesishme per konsolidimin dhe mbrojtjen e interesave te FSASH ne kushtet e reja te krijuara, bazuar ne nenet 6/12 dhe

7/11 te Statutit te FSASH,

V E N D O S I

1. Te shpalle thirrjen e Kongresit te 5-te te Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, para afatit, i cili do te zhvillohet gjate vitit 2013, ne dy sesione.

a) Sesioni i pare i Kongresit te 5-te te FSASH te mblidhet dhe t'i zhvilloje punimet ne Tirane, dite e shtune, date 23 mars 2013, ora 10.00.

b) Sesioni i dyte te zhvillohet brenda djavorit te pare te muajit nentor 2013. Data konkrete e Sesionit te dyte te vendoset nga Keshilli Drejtues i FSASH, jo me vone se 3 muaj para mbajtjes se tij.

2. Tema kryesore e te dy Sesioneve te Kongresit te jete "**Konsolidimi i strukturave te FSASH dhe angazhimi i metejshem per rritjen e profesionalizmit te mesuesve dhe mbrojtjen sociale te tyre**".

3. Norma e perfaqesimit per ne Kongres te jete 1 delegat per 50 anetare qe kane paguar kuotizacionin e anetaresise mbi bazen e mesatares 4 vjecare.

4. Delegatet per Kongresin e 5-te te FSASH zgjidhen nga seksionet sindikale, jo me vone se 20 dite nga mbajtja e Sesionit te pare te Kongresit, bazuar ne numrin e caktuar nga Keshilli Drejtues i Federates.

5. Analiza e veprimtarise sindikale dhe zgjedhjet e organeve drejtuese ne nivel shkolle, rrethi dhe fakulteti, mbi bazen e orientimeve te Sesionit te pare te Kongresit, te zhvillohen gjate muajve maj-qershor dhe shtator-tetor 2013.

6. Keshilli Drejtues i FSASH, brenda dates 10 mars 2013, te miratoje rendin e dites dhe materialet per Sesionin e pare te Kongresit.

Keshilli Drejtues i FSASH

Vijon nga faqja 4

aderon SPASH dhe veçanerisht kontributin e SPASH ne permiresimin e Ligjit te Arsimit Parauniversitar, qe u miratua gjate ketij viti si dhe prezantoi punen e bere nga SPASH dhe ndikimin e saj ne permiresimin e disa elementeve te pages se mesuesve dhe rritjen e tyre.

Ne aspektin organizativ, SPASH gjate vitit 2012 eshte rritur ne numer dhe tashme eshte e shtrire ne te gjitha rrethet e vendit, ku u permenden per rritje te numrit te anetaresise me kuote SPA-te Tirane Qytet, Tirane Qark, Korçe, Elbasan, Lushnje, Delvine, Gramsh e Puke, etj, nderkohe qe per disa rrethe u kerkua funksionimi me i

mire dhe permiresimi i punes nga ana e drejtuesve per rritjen e numrit te anetaresise dhe grumbullimin e kuotizacionit per te gjithë anetaret e deklaruar.

Pas pyetjeve e diskutimeve, Keshillin Kombetar e pershendeti Presidenti i BSPSH-se, Zoti Gezim Kalaja. Ai vleresoi punen e mire te Kryesise dhe Keshillit Kombetar te SPASH-it, si dhe rolin dhe rendesine e kesaj sindikate ne kuadrin e BSPSH-se.

Gjithashtu, ai u ndal ne rendesine e njohjes dhe zbatimit nga gjithë anetaresia te Paktit te Mirekuptimit Social, te nenshkruar midis Keshillit te Ministrave dhe organizatave te punemarresve e punedhenesve, anetare te Keshillit

Kombetar te Punes, me 15 shkurt 2011, si dhe ne kontributin e dhene nga BSPSH ne permiresimet e bera ne Kodin e Ri te Punes, te miratuar ne Keshillin Kombetar te Punes.

Pas diskutimit te pikave te ndryshme, Presidenti i SPASH kerkoi nga te pranishmit me shume mobilizim per vitin e ardhshem, me qellim rritjen e numrit te anetaresise dhe ngritjen ne nje nivel me cilesor te punes drejtuese dhe organizative ne rrethe, duke mbajtur parasysh edhe faktin qe viti 2013 eshte edhe viti i zgjedhjeve ne te gjitha strukturat e SPASH.

*Nevrus Kaptelli
Drejtor i Mardhenieve me Publikun
ne SPASH*

Aktivite me rastin e 100 Vjetorit te Pavaresise

Ne kuadrin e festimeve te 100 Vjetorit te Shpalljes se Pavaresise, Sindikatat e Arsimit, SPASH dhe FSASH, **organizuan, ne qytetin e Shkodres, aktivitetin letrar-artistik “Shkodra ne ditet kur shpallej Pavaresia”.**

Aktiviteti u zhvillua ne sallin e koncerteve prane shkolles artistike “Prenke Jakova”, si bashkepunim ndermjet nxenesve dhe mesuesve te shkolles se mesme “Kole Idromeno” dhe shkolles 9



vjeçare “Ismail Qemali”.

Ne aktivitetin moren pjese mesues, nxenes, prinder e punonjes te tjere te arsimit te rrethit Shkoder, si edhe Drejtori i Arsimit Parauniversitar ne MASH, Z. Fatmir Vejsiu, Drejtorja e DAR Shkoder, Znj. Artrita Feketi, Drejtori i ZA Malesi e Madhe, Z. Ardian Lula, Presidentet e FSASH dhe SPASH, Z. Xhafer Dobrushu dhe Z. Bajram Kruja.

Aktiviteti permbante kenge, recitime, pjese filmike, etj, kushtuar patriotëve te qarkut Shkoder dhe kontributit te tyre ne Shpalljen e Pavaresise. Gjate aktivitetit nxenesit paraqiten punimet e tyre per veprimtare te shquar nga Shkodra si Dede Gjon Luli, Ndre Mjeda, Pashko Vasa dhe Luigj Gurakuqi.

Pjesemarresit duartrokiten gjate kengen per At dheun, Alfabetin, Flamurin si dhe kenge e valle te tjera dhe sidomos kengen “Rrjedhe ne kenge e ligjerime”, e cila u kendua nga nxenesit e shkolles speciale “3 Dhjetori”.

Mbeshtetur ne ditarin e mbajtur nga kontesha Hortensa von Zambauer, gruaja e ambasadorit Austriak ne Shkoder gjate viteve 1912-1913, u ndertua nje dialog artistik ndermjet saj dhe “Qytetit te Shkodres” me teme: “Çfare ndodhte ne Shkoder kur ne Vlore shpallej Pavaresia”.

Nje aktivitet i rendesishem tematiko-

artistik per nder te 100 Vjetorit te Shpalljes se Pavaresise, **u organizua nga Sindikata e Pavarur e Arsimit e rrethit te Elbasanit**, ne ambientet e hotel “Imperial” te ketij qyteti, nen kujdesin dhe me mbeshtetjen e SPASH.

Ne kete aktivitet moren pjese edhe Zv. Ministri i MASH, Z. Ardian Tana, Presidenti i SPASH, Z. Bajram Kruja, Presidenti i Sindikates se Bashkuar te Arsimit dhe Shkences se Kosoves,

(SBASHK), Z. Ali Shabani, drejtori i DAR Elbasan, Z. Mati Çela, pasardhes te partioëve te shquar te ketij rrethi qe kane dhene kontribut ne Shpalljen e Pavaresise, punonjes te DAR dhe bibliotekes Elbasan, mesues etj.

Ne hyrje te sallin ku u mbajt aktiviteti ishte hapur nje ekspozite fotografike, ku pjesemarresit u njohin me figurat patriotike e atdhetare te qytetit te Elbasanit dhe



veprimtarine e kontributin e tyre ne Shpalljen e Pavaresise dhe ngritjen e flamurit ne kete qytet.

Takimin e hapi kryetarja e SPA Elbasan, Znj. Bukuroshe Shabani, e cila prezantoi pjesemarresit, i falenderoi ata dhe drejtoi aktivitetin.

Ne fillim, Zv. Kryetari i SPA Elbasan, Z. Gentjan Dedja, mbajti referatin, me teme: **“Rrethanat historike qe çuan qytetin e**

Elbasanit ne shpalljen e Pavaresise”.

Me pas, te pranishmit i pershendeti Zv. Ministri, Z. Ardian Tana, i cili vleresoi rolin dhe kontributin e patriotëve elbasanas per Shpalljen e Pavaresise dhe falenderoi, ne emer te MASH, SPA dhe DAR Elbasan, per organizimin e ketij aktiviteti.

Drejtori i DAR, Mati Çela, foli mbi Kontributin e Arsimit Elbasanas ne Shpalljen e Pavaresise. Me pas, pershendeti presidenti i SBASHK-ut, Z. Ali Shabani.

Ne kete Takim u mbajten edhe disa referate mbi kontributin e disa figurave te njohura te rrethit te Elbasanit.

Ne fund te pranishmit, ne emer te SPASH, i pershendeti Drejtori i Mardhenieve me Publikun, Z. Nevruz Kaptelli, i cili falenderoi Zv. Ministrin Tana per pjesemarrjen ne kete aktivitet dhe vleresoi MASH per bashkepunimin si edhe SPA Elbasan, te kryesuar nga Znj. Bukuroshe Shabani, per organizimin shume te mire te tij.

Aktivite te ngjashme u organizuan edhe nga sindikatat e rretheve Dures, Lezhe, Korçe etj, te cilat u finalizuan me aktivitetin dy ditor qe SPASH organizoi ne Vlore, me pjesemarrjen e Keshillit Kombetar te SPASH dhe nje delegacioni prej pese vetash te SBASHK, (Kosove).

Gjate dy diteve ne Vlore, u bene vizita ne Shtepine Muze ku u mblodh Qeveria e

Pare Shqiptare, ne Sheshin e Monumentit te Pavaresise, ne varrin e qendistares se flamurit, Marigo Poizo, ne Zverec etj. Ne mbremje u mbajten kumtesa nga drejtuesit e SPA Vlore mbi Shpalljen e Pavaresise se Shqiperise dhe rolin e Arsimit ne te, si edhe nga Z. Ali Shabani, mbi kontributin e patriotëve kosovare ne shpalljen e Pavaresise se Shqiperise.

Bajram Kruja
President i SPASH

Nga veprimtaria e FSASH/SPASH

NXENESIT BRAKTISES KTHEHEN NE SHKOLLE

Ne vijim te angazhimit dhe veprimtarive te tyre per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, per kthimin ne shkollë te nxenesve braktises dhe nxjerrjen nga rreziku i braktisjes te femijeve qe frekuentojne me nderprerje, Sindikatat e Arsimit, FSASH/SPASH, po punojne intensivisht ne disa shkolla te rrethit te Korces, ku ka nje komunitet te ndjeshem nxenesish Rom dhe Egjiptian, te cilet perbejne kontigjentin kryesor te fenomenit te braktisjes se shkolles.

Mbas nje pune dhe pervojë disa vjecare ne shkollat "Naim Frasheri" dhe "Asdreni", kete vit sindikatat jane perqendruar ne shkollat 9/ vjecare "Nuci Naci" dhe "Ismail Qemali".



Fillimisht, me mbeshtetjen e Sindikates Holandeze te Arsimit, AOb, por edhe me mjetet financiare te te dy sindikatave, u mundesua pajisja me libra dhe mjete te tjera shkollore e 80 nxenesve te komuniteteve Rom dhe Egjiptian nga te dyja shkollat.

Puna e sindikatave konsiston ne trajnimin e mesuesve qe merrren me femijet braktises ose ne rrezik braktisjeje, me krijimin e nje fronti te perbashket kunder punes se femijeve, me rritjen e bashkepunimit midis aktoreve qe perbejne kete front, sic jane sindikatat, drejtorite e shkollave, komuniteti i prinderve, qeverite e nxenesve dhe pushtetit vendor.

Mjafte efektive po rezultojne praktikat qe po perdoren per zbutjen dhe eliminimin e fenomenit. Ne secilen shkolle, mesuesit sindikaliste, ne bashkepunim me drejtorine e shkolles, kane evidentuar nominalisht te gjithë nxenesit qe kane braktisur shkollën dhe ata qe perbejne kontigjent per braktisje. Brenda cdo shkolle jane krijuar grupe te posacme me mesues, nxenes e prinder qe punojne me nxenesit individualisht dhe me familjet e tyre, per te mundesuar kthimin e femijeve ne shkolle.

Ne veprimtarite qe u zhvilluan ne keto shkolla ne muajin dhjetor 2012, ne kuader te Projektit qe FSASH/SPASH jane duke zbatuar me sindikaten holandeze AOb, ku moren pjese drejtues te ketyre shkollave, mesuesit qe punojne me nxenes konkret, prinder dhe nxenes, u analizuan gjendja dhe arrijtet e periudhes tremujore per kthimin e nxenesve braktises ne

shkolle. Nga analiza rezultoi se eshte rritur opinioni dhe angazhimi i mesuesve, nxenesve, prinderve dhe drejtorive te shkollave kunder fenomenit te braktisjes dhe, si rezultat i kesaj, 11 nxenes qe kishin braktisur shkollën qe ne fillim te vitit mesimor 2012/2013, u kthyen ne shkollë dhe e frekuentojne ate rregullisht, nderkohe qe 47 nxenes te tjere jane nxjerre nga rreziku i braktisjes.

Prinder te nxenesve qe kane braktisur shkollën ose jane ne rrezik per ta braktisur ate, subjekt i punes qe eshte duke u bere ne keto shkolla ne kuadrin e ketij Projekti, perfshire edhe 14 prinder qe moren pako ushqimore, nepermjet donacionit te fituesit te Cmimit te AOb, Leon

Monitorimit te kesaj shkolle, folen per pervojën e punes dhe rezultatet e arritura ne secilin prej grupeve perkatese.

Prinderit Lola Shkemb, nena e tre femijeve qe ndjekin kete shkolle, Zoica Laloti, nena e nxenesit Samuel Laloti, Arife Mecani, gijshja e nxenesit Xhulian Mecani, Elvira Dalipi, halla e nxeneses Kristina Dalipi, folen per gjendjen e veshitire ekonomike e financiare te familjeve te tyre dhe per perpjekjet qe ato jane duke bere per te rikthyer femijet ne shkolle, duke falenderuar edhe Drejtorine e shkolles, mesuesit, sindikaten Holandeze, AOb, dhe sindikatat shqiptare, FSASH e SPASH, qe jane duke i ndihmuar me tekste e mjete shkollore, veshje e pako ushqimore per te bere te mundur rikthimin dhe mbajtjen e femijeve ne shkolle.

Duke marre pjese ne kete takim, 7 prinder, te cilet moren pakot e para nga donacioni prej Cmimit te AOb, Leon van Gelder, falenderuan shume AOb dhe fituesin e ketij Cmimi, Andreas Schleicher, per kete ndihme shume te vlefshme per familjet e tyre.

Ne takimin e zhvilluar ne shkollën "Ismail Qemali" pervec mesuesve, nxenesve e prinderve, moren pjese edhe Drejtori i shkolles, Ylli Kreka dhe drejtuesit e FSASH e SPASH.

Thomaq Ninka, drejtues i Grupeve te Monitorimit te shkolles, informoi mbi disa konkluzione te nxjerra nga pyetesoret e plotesuar per secilin prej nxenesve qe kane braktisur ose jane ne rrezik per ta braktisur shkollën, ne lidhje me gjendjen e familjeve te tyre, nivelin arsimor te prinderve te tyre, shkaqet e braktisjes se shkolles nga ana e tyre, etj.

Ne vijim, ai evidentoi rezultatet e arritura ne nivel shkolle, si rikthimin ne shkolle te 5 nxenesve, nga 18 nxenes qe kane braktisur shkollën, si edhe daljen nga rreziku i braktisjes te 25 nxenesve nga 110 qe ishin ne rrezik per te braktisur shkollën, duke bere progres edhe ne pervesitim e lendeve mesimore.

Mesuesit, Edlira Mitre, Altin Collaku, Irena Kocaqi, Ardiana Mecollari, folen mbi punen e bere ne Grupet e tyre respektive, duke permendur prinder te cilet kane reflektuar pozitivisht ndaj perpjekjeve te tyre, duke i rikthyer femijet ne shkolle, si edhe per problemet me te cilat ballafaqohen keto familje dhe prinderit e disa nxenesve, sidomos per shkak te gjendjes shume te veshitire financiare.

Prinderit Marsila Kostandini, nena e nxeneses Maradona Kostandini, Marjeta Kupe, nena e nxeneses Haxhire Kupe, Erika Zeqo, nena e nxenesit Leonard Zeqo, Eli Culi, nena e nxeneses Xhulia Culi, Bajame Mehmetali, nena e nxenesit Romeo Mehmetali, te gjithë keta nxenes te rikthyer ne shkolle ne kuadrin e zbatimit te ketij Projekti, vleresuan shume punen e mesuesve e nxenesve te shkolles, si edhe ndihmen qe u eshte dhene atyre per libra e mjete shkollore, pako ushqimore etj, duke premtuar, ne te njejtën kohe, se nuk do t'i largojne me femijet e tyre nga shkollla.

van Gelder, Zv/Drejtorit per Sektorin e Arsimit ne OECD, Andreas Schleicher, si edhe mesues, nxenes e prinder, vecanerisht nga ata qe jane anetare te Grupeve te Monitorimit ne te dy shkollat, **moren pjese ne takimet qe u zhvilluan ne keto dy shkolla, ne muajin dhejtor 2012.**

Kryetari i FSASH-it, Xhafer Dobrush, Drejtori i Mardhenieve me Publikun prane SPASH-it, Nevruz Kaptelli, dhe Kordinatori i Projektit, Stavri Liko, moren pjese, gjithashtu, ne keto takime.

Ne shkollën "Nuci Naci", pervec mesuesve, nxenesve e prinderve, moren pjese edhe Drejtori i shkolles, Stavri Cano, Kryetari i Bordit te Shkolles, Fatos Xhangolli, dhe Kryetari i Shoqates se Romeve per Korcen, Arben Kosturi.

Drejtesja e Grupeve te Monitorimit te shkolles, Sonela Mano, informoi per punen e bere dhe rezultatet e arritura gjate ketyre tre mujave te pare te zbatimit te ketij Projekti, duke u perqendruar sidomos tek roli i prinderve dhe puna e vecante me ta.

Ajo vuri ne dukje disa nga rezultatet e arritura gjate kesaj periudhe, si kthimi ne shkolle i 6 nxenesve nga 14 qe kishin e braktisur ate dhe nxjerrja nga rreziku i braktisjes i 22 nxenesve nga 65 qe ishin ne rrezik per ta braktisur shkollën.

Drejtori i shkolles, Stavri Cano, dhe mesuesit Bukurije Hyska, Marjana Cifligu, Elsa Tona, Viktora Vllahu, qe perfaqesojne kater Grupet e

Ne kujtim te 20 vjetorit te protestes per mbrojtjen e shkolles shqipe ne Kosove

PROTESTA E POPULLIT TE KOSOVES QE SFIDOI REGJIMIN BARBAR SERB

Sot, kur Kosova eshte e lire dhe ka shtetin e saj te pavarur, ka nje sistem arsimit qe hedh hapa te sigurt dhe lulezon qe nga cikli parashkollor deri ne Universitet, kur eshte lene prapa pergjithemone, si nje kujtim i hidhur i te kaluare, politika e eger nacionaliste dhe pushtuese serbomadhe qe i mohonte popullit te Kosoves lirite dhe te drejtat elementare njerezore; qe ushtronte dhunen me cnjerezore kunder shkolles shqipe dhe shkollimit te brezit ri ne gjuhen amtare, nuk eshte e tepert t'i kujtojme brezit te ri ne Kosove, dhe me gjere, se c'perpjekje e sakrificave mbinjerezore, se c'beteja e protesta te parreshtura jane zhvilluar, se sa jete jane sakrifikuar e flijuar per te fituar lirine e shkollimit ne gjuhen amtare, si rruga e vetme per mbrojtjen e identitetit kombetar dhe per te fituar lirine kombetare e shtetore.

E tille eshte edhe protesta masive e 600 mije shqiptareve qe u zhvillua me 12 dhe 13 tetor 1992 per mbrojtjen e shkolles shqipe ne Kosove. Ishte koha kur regjimi i Milloshevicit po ushtronte aparteidin me te eger ne Kosove duke u kthyer ne gjurmet raciste te ideologeve serb te fillimit te shekullit XX. Kjo politike e eger nacionaliste dhe raciste u institucionalizua rishtas me 1989, kur u bene me dhune dhe ne gjendje te jashtezakonshme ndryshimet e Kushtetutes se Kosoves.

Aparteidi ne Kosove u be shembull shkollor i apartheidit ngase perfshinte te gjitha nivelet e arsimit dhe te arsimimit ne gjuhen shqipe, qe nga shkolla filllore deri ne universitet. Shqiptareve me force u mohoheshin te drejtat universale te garantuara, jo vetem me konventa nderkombetare, por edhe me te drejtat legale dhe legitime qe i gezonim qe nga perfundimi i Luftes se Dyte Boterore. Shkollat shqipe u mbylleen. U mbyll edhe Universiteti i Prishtines, ndersa mesuesit dhe pedagoget u larguan me dhune nga puna. Ne Kosove, institucionet arsimore funksiononin vetem ne gjuhen serbe, pra per me pak se 10 perqind te popullsise se Krahines.

Me pershkallezimin e terrorit shtetror serb, rritej edhe shkalla e organizimit te shqiptareve, si dhe shtrengoheshin e shtoheshin rradhet e pjesmarresve, vecmas kur kishim te benim me mohimin e nje te drejte elementare, sa kombetare aq edhe universale, sic ishte e drejta per arsim cilesor per te gjitha. Keshtu linden format e organizimit dhe te protestave paqesore ne shkalle vendi per shkollen shqipe, kunder diskriminimit e dhunes ndaj saj. U formua Keshilli Organizativ i perbere nga Lidhja e Arsimitareve Shqiptare, Sindikata e Pavarur e Arsimit, Shkences dhe e Kultures, Shoqata e Pavarur e Arsimitareve Universitar dhe e punonjesve Shkencor, Unioni i Studenteve,

Keshilli per Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut ne Prishtine, u krijuan partite politike te Kosoves.

Keshilli Organizativ, qe funksiononte ne nivel qendror dhe vendor, mori persiper detyren e organizimit te protestave paqesore ne mbeshtetje te shkolles dhe shkollimit shqip.

Protestat kishin per qellim kthimin e nxenesve, te studenteve dhe te arsimitareve ne menyre paqesore ne objektet e veta shkollore; deshmimin e vendosmerise se nuk do te heqin dore nga objektet e veta shkollore dhe nga arsimit dhe shkollimi ne gjuhen e tyre amtare, si nje e drejte universale dhe kombetare, si edhe te njoftonin opinionin boteror per gjendjen e rende te arsimit dhe te shkolles shqipe ne Kosove ne kushte te apartheidit dhe te diskriminimit sistematik serb.

Ne emer te Keshillit Qendror te Protestave, ne konferencen per shtyp mbajtur nje dite para protestave, iu drejtuam qytetareve me keto fjale :” Me 12 tetor eshte parapare shkuarja e nxenesve dhe arsimitareve ne shkollat e tyre te mbyllura me dhune nga pushteti serb, tri vite me pare. Neqoftese as neso nuk na lejohet hyrja normale ne ndertesat tona shkollore, atehere do te mbahen protesta gjithpopullore para institucioneve shkollore te uzurpuara. Do te jete kjo proteste e qete kunder segregacionit dhe apartheidit, presionit dhe represionit sistematik serb ndaj shkolles shqipe... Do te jete ky nje ballafaqim i aresyes dhe dhunes, i te drejtes perballa te padrejtes, i levizjes paqesore kunder terrorit shtetror serb, i kerkeses per vetvendosje edhe ne sferen e arsimit dhe te refuzimit kolonialist serb. Kerkojme, u tha ne konferencen, ruajtjen e kontinuitetit, mevetesine e teresise se shkolles shqipe ne Kosove dhe pezullimin e te gjitha formave diskriminuese serbe...”

Kerkesat themelore te Keshillit Organizativ te Protestave, ishin: hapja e menjehershme e objekteve, institucioneve shkollore, shkencore dhe kulturore per nxenesit, studentet dhe mesimdhenesit shqiptare; hapja e konvikteve per nxenesit dhe studentet shqiptare; heqja e masave te dhunshme mbi institucionet e arsimit, te shkences dhe te kultures ne Kosove; kthimi i mjetve financiare dhe mesimore te plackitura, lirimin nga burgu dhe nderprerjen e ndjekjeve penale dhe kundervajtese ndaj te gjitha veprimtareve te arsimit shqip, etj.

Ashtu sic pritej, ne proteste per shkollen shqipe dhe kunder dhunes ndaj saj, moren pjese nje numer i madh i qytetareve te te gjitha moshave, afro 600 mije protestues, qe perbenin afer 1/3 e popullsise shqiptare ne Kosove. Vetem ne kryeqytetin e Kosoves muaren pjese mbi 100 mije protestues.

Duke i bere jehone protestes, gazeta ditore “Bujku” shkruante: “... Pasi nga pushteti serb serish nuk u lejua hyrja ne shkolla e ne fakultete, pjesmarresit mbajten nje ore te madhe kunder dhunes ne arsimin shqiptar, duke u tubuar ne vendet publike dhe duke parakaluar rrugeve ne kolona te pafundme. Karakteristike e ketyre manifestimeve ishte organizimi shume i mire, qendrimi dinjitoz dhe i qete i protestuesve, vetorganizimi dhe mbajtja e rendit nga organizatorët dhe nga vet pjesmarresit, parullat dhe transparentet, si dhe prania e madhe e forcave te milicise serbe, e cila plagosi, rrahu dhe burgosi pjesmarres te tubimeve ne disa qendra te Kosoves”.

Protestat vazhduan edhe ne mesditen e 13 tetorit ne shkalle vendi. Para shkollave dhe fakulteteve te Universitetit te Prishtines, provuan te tubohen, nxenes, studente, arsimitare, prinder dhe qytetare. Ndonese keto tubime ishin paralajmuerar si paqesore, policia serbe pengoi ne shume qendra komunale hyrjen e qytetareve ne qytete, ndersa ne oren 12, kur filluan protestat, policia intervenoi duke perdorur dhunen, gazin lotsjelles, e, ne ndonje rast, edhe armet e zjarrit.

Ne te gjitha tubimet protestuese ne Kosove pjesmarresit brohoritnin parulla dhe mbanin pankarta te shkuara ne gjuhen shqipe, angleze dhe gjermane, ku thuhej: “Hapni shkollat, shkolla eshte e jona; Universitet, Liri, Demokraci, shkolle-paqe, policet jasht shkollave, etj.”.

Nga kjo dhune e policise serbe, me perforcime nga Krushevi, Nishi, Kraleva, Svetozareva etj, brenda nje dite te protestave u arrestuan dhe u keqtrajtuuan, u burgosen dhe u denuan me burg me qindra pjesmarres; u plagosen rende qindra nxenes, arsimitare e arsimitare si dhe profesore te moshuar te universitetit; e pesoi rende edhe nxenesja e mitur, Sabrie Rustaj, ne Peje, te ciles polici me nje te goditur me shufër gome i keputi veshin. U thirren ne polici dhe u kercenuan profesori i njohur Fehmi Agani dhe drejtuesit kryesor te Keshillit te Protesave.

Protesta per shkollen shqipe e 12 dhe 13 tetorit 1992, qe u mbajt ne tere Kosoven, ishte madheshtore per nga pjesmarrja dhe dinjitoze per nga qendrimi dhe vendosmeria e protestuesve, perkunder dhunes se ushtruar ndaj tyre nga policia serbe.

Protesta vuri ne levizje edhe diplomacine Boterore. Ajo u ndoq dhe u pasqyrua me nje interesim te vecante edhe nga agjensite me te njohura te informimit, duke percjellur jehonen e tyre ne tere boten demokratike.

*Prof. Dr. Agim HYSENI
Kryetar i Keshillit Qendror te Protestave*

SHENIM I REDAKSISE

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 8872 datë 29.3.2002 “ Per Arsimin dhe Formimin Profesional ne Republikën e Shqipërisë, (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i AFP-se diskutoi draftin e “Strategjise se Arsimin dhe te Nxënit Gjate Gjithe Jetes 2013-2020”.

Per te kuptuar me mire bazen ligjore te kesaj Strategjie dhe per te pasur tashme nje kuader te plote ligjor per gjithe arsimin parauniversitar, mbas botimit ne Nr. 44 te Revistes “ Tribuna Sindikale” te Ligjit per Sistemin Arsimor Parauniversitar, po botojme ne kete numer edhe Ligjin “ Per Arsimin dhe Formimin Profesional ne Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar.

LIGJ**Nr. 8872, datë 29.3.2002****PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË,****I NDRYSHUAR ME LIGJET****Nr. 10 011, datë 30.10.2008****Nr. 10434, datë 23. 6. 2011**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:****KREUI
DISPOZITATË PËRGJITHSHME****KREUI****DISPOZITATË PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi i ligjit**

1. Qëllimi i këtij ligji është të mbështesë zhvillimin e një sistemi të përbashkët të arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, i cili mund t’u përshtatet ndryshimeve shoqërore, ekonomike e teknologjike, nevojave të tregut të punës, si dhe të mundësojë një shfrytëzim optimal të burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore.

2. Ky ligj vendos parimet themelore, strukturën, organizimin dhe administrimin e arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, mbështetur në bashkëpunimin e institucioneve shtetërore, qeveritare me partnerë socialë dhe aktorë të tjerë në fushën e arsimit dhe formimit profesional.

3. Ky ligj garanton të drejtën e shprehur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për arsimim dhe formim profesional gjatë gjithë jetës, mundësinë e kryerjes së arsimimit fillestar profesional, si dhe të fitimit të njohurive profesionale të nevojshme për punësim, duke krijuar shanse të barabarta për të gjithë.

Neni 2**Objektivat e arsimit dhe formimit profesional**

Ky ligj përcakton objektivat kryesorë të sistemit të arsimit dhe formimit profesional, të cilat janë:

a) të zhvillojë karakteristikat personale kryesore të individit, të nevojshme për veprimtarinë e tij të ardhshme profesionale dhe ekzistencën e

pavarur brenda një shoqërie të bazuar në parimet e demokracisë dhe të ekonomisë së tregut;

b) të përshtasë arsimin dhe formimin profesional në tregun e sotëm dhe të ardhshëm të punës;

c) të ofrojë dhënien e një kulture profesionale të përgjithshme dhe të një formimi profesional të specializuar, në përputhje me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë, si dhe me kulturën dhe traditën kombëtare;

ç) të krijojë kushte për arsimim dhe formim profesional, me qëllim aftësimin e individit për t’iu përshtatur ndryshimeve dhe kërkesave të tregut të punës;

d) të rrisë frytshmërinë e përdorimit të infrastrukturës së sistemit të arsimit dhe formimit profesional.

Neni 3

Arsimi dhe formimi profesional është publik dhe jopublik dhe garantohej nga shteti.

Neni 4**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “**Sistemi i arsimit dhe formimit profesional**” (më poshtë “AFP”) është sistemi që përfshin të gjitha llojet e institucioneve që mbështesin dhe ofrojnë të gjitha llojet e programeve të arsimit dhe kurseve të formimit, sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve për nivelet 2, 3, 4 dhe 5.

b) “**Të nxënit formal në AFP**” është të nxënit që kryhet në një mjedis të organizuar dhe të strukturuar, të tilla si: institucionet e arsimit të lartë, shkollat,

qendrat e formimit ose në punë dhe që është hartuar qartë si formë mësimore, në lidhje me objektivat, kohën dhe burimet. Të nxënit formal është i qëllimshëm dhe i planifikuar nga nxënësi, kursanti apo studenti. Përfundimi i këtij të nxëni certifikohet.

c) “**Të nxënit joformal në AFP**” është të nxënit, përfshirë në veprimtari të planifikuara, jo domosdoshmerisht të hartuara si forma mësimore, në lidhje me objektivat, kohën mësimore ose mbështetjen mësimore, por që përmban elemente të rëndësishme mësimore. Të nxënit joformal është i qëllimshëm, i planifikuar nga nxënësit, kursantët apo studentët, i cili në përgjithësi nuk certifikohet, por në raste të veçanta mund të certifikohet.

ç) “**Të nxënit informal në AFP**” është të nxënit, i cili përfitohej nga veprimtari të përditshme, që kanë lidhje me punën, familjen ose kohën e lirë. Ky lloj të nxëni nuk është i strukturuar dhe i organizuar për sa i përket objektivave, kohës apo mbështetjes mësimore. Në shumicën e rasteve, të nxënit informal është i paqëllimshëm, i paplanifikuar nga individit që nxë, si rregull nuk certifikohet.

d) “**Të nxënit gjatë gjithë jetës**” përfshin të gjitha veprimtaritë e të nxënit, të ndërmarra gjatë gjithë jetës për zhvillimin e aftësive dhe arritjen e një kualifikimi.

dh) “**Institucionet mbështetëse të AFP-së**” janë institucionet publike dhe private, të cilat mbështesin arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë.

e) “**Institucionet ofruese të AFP-së**”

Vijon në faqen 10

Vijon nga faqja 9

janë institucione publike dhe private, të cilat sigurojnë programe ose/dhe kurse të AFP-së në Republikën e Shqipërisë.

ë) **“Qendrat e formimit profesional”** janë institucione publike ose private ofruese të AFP-së, të cilat sigurojnë kurse të formimit profesional për kursantët.

f) **“Qendrat shumëfunktionale ofruese të AFP-së”** janë institucione, publike dhe private, ofruese të AFP-së, që sigurojnë arsimim profesional me nivele të ndryshme dhe kurse të formimit profesional.

g) **“Shoqëri tregtare”** (më poshtë “shoqëri”) është personi juridik sipas përcaktimeve në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

gj) **“Nxënës”** është personi, i cili merr arsim në sistemin formal, joformal dhe informal të arsimit.

h) **“Kursant”** është personi, i cili merr formim në sistemin formal, joformal dhe informal të formimit.

i) **“Mësues”** është personi i kualifikuar me aftësi pedagogjike e profesionale dhe që angazhohet në AFP kryesisht për trajtimin e aspekteve teorike të procesit mësimor.

j) **“Instruktor”** është personi i kualifikuar me aftësi pedagogjike e profesionale dhe që angazhohet në AFP kryesisht për trajtimin e aspekteve praktike të procesit mësimor.

k) **“Partnerë socialë”** janë organizatat që përfaqësojnë interesat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, të cilat marrin pjesë dhe kontribuojnë në sistemin e AFP-së.

l) **“Partnerë të tjerë”** janë organizatat jofitimprurëse, komunitetet e ndryshme, që marrin pjesë në sistemin e AFP-së dhe, së bashku me institucionet administrative shtetërore, punojnë për zbatimin e këtij ligji.

II. “Certifikatat” (dëshmitë) e llojeve të ndryshme janë dokumente zyrtare që vërtetojnë përmbushjen, nga ana e nxënësve dhe kursantëve, e arritjeve të programeve të akredituara të AFP-së.

m) **“Kualifikimi”** është specifikimi i standardeve në njohuri, aftësi dhe kompetenca të gjera, hartuar për të përmbushur një qëllim të caktuar, që i është njohur vlefshmëria ose është njohur zyrtarisht për këtë qëllim. Dhënia e kualifikimit për një individ nënkupton që,

njohuritë dhe aftësitë e këtij individi kanë vlerë në tregun e punës dhe në arsimimin dhe formimin e mëtejshëm të tij. Kualifikimi jepet, kur një organ kompetent përcakton, nëpërmjet një procesi vlerësimi të sigurisë së cilësisë, se individi i ka arritur standardet e specifikuar.

n) **“Korniza Shqiptare e Kualifikimeve”**, më poshtë KSHK, është një sistem kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve, sipas një tërësie kriteresh, për nivele specifike të të nxëniet të përfutur, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, përparimit dhe cilësisë së kualifikimeve, që lidhen me tregun e punës dhe shoqërinë civile.

nj) **“Forma e dyfishtë”** është një lloji ofrimit të arsimit dhe formimit profesional, i cili kombinon arsimin dhe formimin në një institucion të AFP-së me punën dhe aftësimin praktik në një shoqëri tregtare, nëpërmjet përcaktimeve të një marrëveshjeje midis pjesëmarrësit, institucionit të AFP-së dhe shoqërisë tregtare.

o) **“Akreditimi i kurseve dhe i programeve të AFP-së”** është procesi i certifikimit të kompetencës apo besueshmërisë dhe njohjes së certifikatave që oëmbajnë dhe kreditit e fituara.

p) **“Licencim”** është akti juridik që i njeh institucionit ofrues të AFP-së të drejtën të ofrojë llojin e veprimtarisë sipas kushteve dhe kërkesave të paracaktuara.

q) **“Njohja e të nxëniet të mëparshëm”** informal dhe formal është procesi, me anë të të cilit kompetencat e mëparshme të një personi, të fituara në sistemin informal dhe jo formal mund të merren parasysh përmes një vlerësimi që çon në dhënie të një certifikate të kualifikimit formal.

r) **“Arsimi pas së mesmes”** përfaqëson një nivel arsimor që u ofrohet nxënësve që kanë përfunduar arsimin e mesëm, por me programe studimi të nivelit jouniversitar.”.

Neni 5

Nga ky ligj përfitojnë:

a) të gjithë personat që kanë përfunduar arsimin e detyruar;

b) personat që kanë mbushur moshën 16 vjeç, që janë kërkues pune dhe/ose dëshirojnë të formohen profesionalisht;

c) grupe të veçanta, që dëshirojnë

riaftësim profesional, si personat me aftësi të kufizuar, nënat me shumë fëmijë, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë dhe çdo kategori tjetër që do të përcaktohet si e tillë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Llojet, nivelet dhe kohëzgjatja e arsimit dhe formimit profesional AFP-ja përbëhet nga:

a) **Arsimi profesional publik dhe privat**, që fillon pas përfundimit të arsimit bazë, ofrohet në shkollat profesionale dhe është me kohëzgjatje 2 - 4-vjeçare. Sistemi i arsimit profesional ofron nivelet e mëposhtme të arsimit:

i. **Arsim profesional bazë i nivelit I**, i orientuar sipas drejtimeve të gjera profesionale, me kohëzgjatje 2 (dy) vite shkollore pas përfundimit të arsimit bazë. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë të përgatitjes bazë profesionale dhe lejon kalimin në nivelin II të arsimit profesional ose në tregun e punës.

ii. **Arsim profesional i nivelit II**, i orientuar sipas profileve profesionale për çdo drejtim profesional, me kohëzgjatje 1(një) vit shkollor pas përfundimit të arsimit profesional bazë. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë të përgatitjes profesionale dhe lejon kalimin në nivelin III të arsimit profesional ose në tregun e punës.

iii. **Arsim i mesëm profesional, teknik/menaxherial, i nivelit III**, i orientuar sipas profileve profesionale, me kohëzgjatje 1 (një) vit shkollor pas përfundimit të nivelit II (struktura 2+1+1) ose 2 (dy) vite shkollore pas përfundimit të nivelit I (struktura 2+2), të arsimit profesional. Në raste të veçanta, ka kohëzgjatje 4 (katër) vite pas përfundimit të arsimit bazë. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatën e teknikut/menaxherit në profesionin përkatës, si dhe me diplomën e maturës shtetërore profesionale, dhe lejon kalimin në tregun e punës dhe në arsimin tretësor.

b) **Arsimi profesional pas së mesmes (jouniversitar)**, publik dhe privat, me kohëzgjatje 1 - 2 vite shkollore, fillon pas përfundimit të arsimit të mesëm profesional (nivele III) ose të gjimnazit. Në përfundim të tij ofrohet certifikatë e kualifikimit profesional në profesionin përkatës dhe mundësohet kalimi në tregun e punës. Kur zgjat dy vite shkollore dhe

grumbullon 120 kredite europiane (ECTS), përfundon me marrjen e diplomës “Diplomë profesionale ...” në fushën e arsimit të kryer. Kjo diplomë mundëson kalimin në tregun e punës, si dhe transferimin e krediteve në studimet universitare të ciklit të parë në fushën e arsimit profesional përkatës.

c) **Formimi profesional, publik dhe privat**, fillon pas përfundimit të arsimit bazë, ofrohet në qendrat e formimit profesional dhe zgjat deri në 2 (dy) vite shkollore. Formimi profesional realizohet nëpërmjet kurseve të formimit, të riformimit, si dhe të kurseve-urë të riaftësimi profesional, në mbështetje të rihyrjes dhe të kalimit nga një profesion në një tjetër. Formimi profesional ofron certifikata të kualifikimit profesional.

c) **Arsimi dhe formimi profesional në formë të dyfishtë**, i cili kombinon arsimimin dhe formimin profesional në shkollë/qendër (për pjesën teorike) me punën dhe aftësitë praktike në shoqëri (për pjesën praktike), nëpërmjet përcaktimeve të një marrëveshjeje midis pjesëmarrësit, institucionit të AFP-së dhe shoqërisë.

d) **Lloje të tjera të AFP-së**, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

KREUII KRITERE TË PËRGJITHSHME

Neni 7

Institucionet e arsimit dhe formimit profesional janë:

a) Shkollat profesionale, publike dhe private, të cilat mund të ofrojnë të gjitha llojet dhe nivelet e arsimit profesional parauniversitar. Këto shkolla realizojnë përgatitjen profesionale me karakter të theksuar praktik dhe u japin nxënësve njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale.

b) Qendrat shumëfunktionale, publike dhe private, të cilat mund të ofrojnë të gjitha llojet dhe nivelet e arsimit profesional parauniversitar, si dhe kurse të formimit profesional për të rritur, në po ato drejtime ku ofrojnë dhe arsimimin profesional.

c) Qendrat e formimit profesional, publike dhe private, të cilat mund të ofrojnë kurse të ndryshme të formimit profesional (formim, riformim dhe riaftësim profesional), për fitimin e

aftësive të nevojshme profesionale për t’iu përshtatur kërkesave të tregut të punës.

c) Institucionet e specializuara të arsimit dhe formimit profesional për grupe të veçanta.

d) Ndërmarrjet.

d) Institucionet e tjera, publike dhe private, përfshirë institucionet e arsimit të përgjithshëm dhe të lartë.

Neni 7/1

Bordi i institucioneve publike ofruese të AFP-së

1. Bordi i institucioneve publike ofruese të AFP-së (më poshtë “Bordi”), është organ kolegjal, që përfaqëson interesat e nxënësve/kursantëve, të komunitetit të biznesit, të partnerëve socialë, si dhe të pushtetit vendor. Bordi mbështet institucionin në zhvillimin e profilit të tij në tregun e AFP-së, të lidhur ngushtë me tregun e punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit, dhe mbikëqyr veprimtarinë që lidhet me drejtimin dhe administrimin ekonomik, financiar dhe të pronave të institucionit.

2. Bordi përbëhet nga:

a) dy përfaqësues të sektorit privat që lidhet me profilin e institucionit të AFP-së;

b) një përfaqësues i Drejtorisë Arsimore, që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së (për shkollat publike profesionale);

c) një përfaqësues i Këshillit të qarkut, që mbulon institucionin arsimor publik ofrues të AFP-së;

c) një përfaqësues i zyrës rajonale/vendore të punësimit, që mbulon institucionin arsimor publik ofrues të AFP-së;

d) një përfaqësues i personelit mësimdhënës të institucionit publik, ofrues të AFP-së;

dh) një përfaqësues i nxënësve për shkollat publike të arsimit profesional ose një përfaqësues i punëmarrësve për qendrat publike të formimit profesional.

3. Bordi zgjedh kryetarin prej anëtarëve përfaqësues të sektorit privat.

4. Të drejtat dhe detyra të tjera të bordit, mandati, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve, si dhe funksionimi i tij përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Bordi mbledhet një herë në 3 (tre) muaj dhe anëtarët e Bordit përfitojnë shpërblim për çdo mbledhje nga të ardhurat e shkollës/qendrës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për shpërblimin e bordeve, nëse shkolla/qendra realizon të ardhura.

Neni 8

Licencimi i institucioneve private të arsimit dhe formimit profesional

Licencimi i institucioneve private të arsimit profesional dhe/ose subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional bëhet në bazë të kushteve dhe të kriterëve që përcaktohen në udhëzimet e nxjerra në mënyrë specifike për to nga ministritë përkatëse. Ky proces kryhet në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Licencimeve.

Neni 9

Akreditimi i programeve të arsimit dhe formimit profesional

1. Akreditimi i programeve të AFP-së kryhet nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFP), në përputhje me nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe në bazë të sistemit të sigurimit të cilësisë.

2. Standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit për sistemin e arsimit profesional miratohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ndërsa për sistemin e formimit profesional miratohen nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta”.

Neni 10

Pranimi në arsimin dhe formimin profesional

1. Në shkollat profesionale pranohen të gjithë individët që kanë përfunduar arsimin e detyruar dhe kanë marrë dëftesën e lirit. Kriteret e pranimeve dhe procedurat e regjistrimit vendosen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Në qendrat e formimit profesional, publike dhe private, kurset dhe programet e formimit, riformimit dhe të rikualifikimit profesional të akredituara janë të hapura për të gjithë personat që përmbushin kriteret për hyrjen, pranimin dhe regjistrimin në to, të përcaktuara si pjesë e procesit të akreditimit.

Vijon nga faqja 11

Neni 11

Hyrja, vijimi dhe transferimi nga një nivel/drejtim i AFP-së në një nivel/drejtim tjetër

Hyrja, vijimi dhe transferimi nga një nivel/drejtim i AFP-së në një nivel/drejtim tjetër bëhet sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

Neni 12

Vlerësimi përfundimtar në arsimin dhe formimin profesional

Vlerësimi përfundimtar i nxënësve dhe i kursantëve në arsimin dhe formimin profesional publik dhe jopublik, të akredituar, bëhet në bazë të provimeve, me pjesëmarrjen edhe të partnerëve socialë. Kriteret dhe rregullat e provimeve dhe të testeve përcaktohen me udhëzim të ministrit përkatës. Vlerësimi përfundimtar, bazuar në sistemin e krediteve në kualifikimet me orientim profesional, bëhet në përputhje me kriteret e paracaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Neni 13

Certifikimi

1. Certifikimi i nxënësve dhe kursantëve në AFP bëhet në përputhje me kriteret e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

2. Ministri i Arsimit dhe Shkencës përcakton llojin, përmbajtjen, formatin dhe procedurën e dhënies së dokumentave të certifikimit për nxënësit në sistemin e arsimit profesional, sipas niveleve të përcaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

3. Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta përcakton llojin, përmbajtjen, formatin dhe procedurën e dhënies së dokumentave të certifikimit për kursantët në sistemin e formimit profesional, sipas niveleve të përcaktuara në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

Neni 14

Këshillimi dhe orientimi në arsimin dhe formimin profesional

Me këshillimin dhe orientimin në arsimin dhe formimin profesional synohet

që të ndihmohen të gjithë shtetasit në zgjedhjen e arsimit, të profesionit, të formimit, të riformimit dhe të riaftësimin profesional më të përshtatshëm për interesat dhe mundësitë fizike e mendore të tyre. Ministrinë përkatëse nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij neni.

Neni 15

Dokumentimi, informacioni dhe statistikat

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale janë përgjegjëse për dokumentimin, për dhënien e informacionit dhe për mbajtjen e statistikave të arsimit dhe formimit profesional, sipas fushave përkatëse që ato mbulojnë. Të gjitha ministrinë e tjera, pushteti vendor, si dhe të gjithë përgjegjësit e tjerë të AFP-së, në nivel kombëtar apo vendor, janë të detyruar të japin informacion për veprimtaritë e AFP-së në këto dy ministri. Procedurat e mbledhjes, të raportimit të informacionit dhe shpeshësia e dhënies së informacionit përcaktohen me udhëzime të përbashkëta.

Neni 16

Personeli në arsimin dhe formimin profesional

1. Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional angazhohet personel mësimdhënës teorik e praktik, personel drejtues dhe personel ndihmës.

2. Personeli i mësimdhënies teorike dhe praktike përbëhet nga:

- a) mësuesit e kulturës së përgjithshme
- b) mësuesit e kulturës profesionale
- c) mësuesit e formimit praktik në shkollat profesionale
- ç) instruktorët e formimit profesional në qendrat e formimit

3. Trajnimi dhe kualifikimi fillestar i mësuesve dhe i instruktorëve në përputhje me shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 2, të këtij neni, janë përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

4. Trajnimi dhe kualifikimi i vazhduar për personelin e angazhuar në institucionet arsimore profesionale janë përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, kurset për personelin e angazhuar në qendrat e formimit profesional janë përgjegjësi e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në përputhje me pikën 2, shkronja “ç”, të këtij neni.

Neni 17

Shoqëritë tregtare

1. “Shoqëria tregtare” është subjekti ku mund të organizohen kurset e formimit nëpërmjet punës dhe ku mund të zhvillohen praktikat profesionale të nxënësve dhe të kursantëve të sistemit të AFP-së.

2. Shoqëritë tregtare, të cilat pranojnë nxënësit e shkollave profesionale për të zhvilluar praktikën mësimore, në kuadër të programit mësimor përkatës, mbështeten nga shteti. Format e mbështetjes, kriteret dhe kushtet për përfitimin e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Përfshirja e shoqërive në sistemin publik të AFP-së rregullohet me anë të marrëveshjeve që lidhen ndërmjet shoqërive tregtare dhe institucioneve ofruese arsimore publike. Kohëzgjatja e përfshirjes së shoqërive tregtare në sistemin publik kushtëzohet nga programet e praktikave profesionale dhe nga kurset e formimit.

Neni 18

Vlerësimi i sistemit

Mekanizmat e zhvillimit dhe të vlerësimit të sistemit të arsimit dhe formimit profesional janë përgjegjësi e ministrive përkatëse.

KREUIII

KOORDINIMI ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

Neni 19

Kriteret e përgjithshme të Koordinimit

1. Koordinimi i përgjithshëm i sistemit të arsimit dhe formimit profesional publik dhe jopublik bëhet nga shteti.

2. Institucionet dhe organizmat përgjegjës të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri janë:

- a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për arsimimin profesional.
- b) Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, për formimin profesional.
- c) Ministrinë dhe institucionet e tjera publike dhe jopublike.
- ç) Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional.

d) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;

dh) Institucionet e Kornizës

Shqiptare të Kualifikimeve:**e) Institucione të tjera, të përcaktuara me akte nënligjore.****Neni 20****Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional**

1. Këshilli Kombëtar i AFP-së është organ këshillimor trepalësh (shtet-punëmarrës-punëdhënës). Ai u rekomandon ministrive përgjegjëse dhe Këshillit të Ministrave politika për zhvillimin e sistemit të AFP-së.

2. Këshilli Kombëtar i AFP-së përbëhet nga 10 anëtarë:

a) Ministri i Arsimit dhe Shkencës, bashkëkryetar

b) Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, bashkëkryetar

c) Një përfaqësues i Ministrisë së Financave

ç) Një përfaqësues i Ministrisë së Ekonomisë

d) Katër anëtarë, përfaqësues të punëdhënësve

dh) Dy anëtarë përfaqësues të punëmarrësve

3. Funksionimi i Këshillit Kombëtar të AFP-së organizohet nga një sekretariat teknik, i cili përbëhet nga punonjës të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të AFP-së dhe e sekretariatit teknik përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21**Kompetencat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në fushën e arsimit profesional**

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka këto kompetenca:

a) Përpunon, zhvillon dhe zbaton politikat për reformimin dhe modernizimin e arsimit profesional, në përputhje me drejtimit europiane të zhvillimit të AFP-së.

b) Përcakton kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve që ofrojnë arsim profesional

c) Përcakton kriteret e përgjithshme për marrjen në punë, për kualifikimin dhe për certifikimin e mësuesve në arsimin profesional, në bashkëpunim me institucionet e specializuara.

ç) Krijon, riorganizon dhe mbyll

institucionet e arsimit profesional publik, që varen nga ajo, në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

d) Harton akte nënligjore për statusin e institucioneve publike ofruese të arsimit profesional, shkallën e autonomisë së tyre dhe funksionimin e bordit.

dh) Bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Licencimeve, për licencimin e institucioneve arsimore private të arsimit profesional dhe vendos mbylljen e veprimtarisë së këtyre institucioneve, në rast shkeljeje të akteve, ligjore e nënligjore, në fuqi.

e) Miraton kurrikulat në nivel qendror për kualifikimet e arsimit profesional.

ë) Realizon testimin dhe certifikimin e nxënësve në shkollat e arsimit profesional, në bashkëpunim me institucionet e specializuara.

f) Mbikëqyr veprimtarinë e institucioneve të arsimit profesional që varen prej saj.

g) Nxjerr akte nënligjore të përbashkëta me Ministrinë e Punës, Çështjes Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në mënyrë që, krahas arsimimit profesional të nxënësve, në shkollat profesionale, publike dhe private, të ofrohen edhe kurse formimi profesional, si shërbime për llogari të të tretëve.

Neni 22**Kompetencat e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në fushën e AFP-së.**

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka këto kompetenca:

a) Përpunon, zhvillon dhe zbaton politikat për reformimin dhe modernizimin e formimit profesional, në përputhje me drejtimit europiane të zhvillimit të AFP-së.

b) Përcakton kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve të formimit profesional.

c) Përcakton kriteret e përgjithshme për marrjen në punë, për kualifikimin dhe për certifikimin e instruktorëve të formimit profesional në bashkëpunim me institucionet e specializuara.

ç) Krijon, riorganizon dhe mbyll institucionet e formimit profesional në varësi të saj, në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

d) Harton akte nënligjore për statusin e institucioneve publike ofruese të formimit profesional, për shkallën e autonomisë së tyre dhe për funksionimin e bordit.

dh) Bashkëpunon me Qendrën Kombëtare të Licencimeve për licencimin e subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional.

e) Miraton kurrikulat në nivel qendror për veprimtaritë e formimit profesional.

ë) Merr pjesë në vlerësimin përfundimtar dhe në certifikimin e kursantëve në institucionet e formimit profesional që varen prej saj.

f) Mbikëqyr veprimtarinë e institucioneve të formimit profesional që varen prej saj.

g) Siguron vazhdimësinë e formimit profesional në përputhje me perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar dhe rajonal dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

gj) Garanton të drejtën e individit për formimin profesional, duke lehtësuar pengesat ekonomike dhe shoqërore për vazhdimin e këtij formimi.

h) Organizon kualifikimin e vazhdueshëm të instruktorëve të formimit profesional në sektorin publik, në bashkëpunim me institucionin e përcaktuar.

Neni 23**Kompetencat e ministrive të tjera dhe të institucioneve shtetërore të arsimit dhe formimit profesional**

Ministritë dhe institucionet e tjera shtetërore të formimit profesional:

a) krijojnë, organizojnë dhe mbyllin institucionet e formimit profesional që varen prej tyre, në përputhje me procedurat ligjore;

b) përgatisin kurrikulat e formimit profesional, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të përcaktuara me ligj;

c) organizojnë formimin, nëpërmjet punës, të punonjësve të tyre dhe rikualifikimin e specialistëve në institucionet që ofrojnë këtë shërbim;

ç) organizojnë testimin dhe certifikimin e specialistëve në institucionet që varen prej tyre;

d) marrin pjesë në procesin e hartimit të standardeve shtetërore të kualifikimeve profesionale, në bashkëpunim me

Vijon nga faqja 13

Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve; dh) marrin pjesë në studime për analizën, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë që ofrohet në AFP, në bashkëpunim me institucionet e AFP-së.

Neni 23/1

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)

1. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) është institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe ka objekt kryesor të veprimtarisë së saj krijimin e një sistemi kombëtar e unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar, bazuar në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve:

a) është një ndër njësitë zbatuese për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe shërben si sekretariat për Këshillin e KSHK-së;

b) harton plane dhe programe për zhvillimin e sistemit të AFP-së, që miratohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

c) harton programe për realizimin e politikave për zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

ç) harton programe për zbatimin e sistemit të sigurimit të cilësisë nga institucionet ofruese të AFP-së.

a. AKAFPK-ja është një ofrues shërbimi për ministrinë të përkatëse.

b. AKAFPK-ja mban regjistrin kombëtar të kualifikimeve kombëtare.

c. Organizimi dhe veprimtaria e AKAFPK-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Kompetencat e pushtetit vendor në fushën e arsimit dhe formimit profesional

Pushteti vendor:

a) propozojnë hapjen dhe mbylljen e drejtimeve, profileve, specialiteteve në shkollat profesionale, si dhe hapjen e shkollave të reja, në përputhje me nevojat e zhvillimit rajonal.

b) Në bashkëpunim me institucionet ofruese të AFP-së kujdeset dhe mirëmban institucionet e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

c) hap kurse të formimit profesional me fondet e veta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

ç) Përfaqësues të pushtetit vendor marrin pjesë në bordet e shkollave.

Neni 25

Kompetencat e partnerëve socialë

Partnerët socialë:

a) propozojnë hapjen dhe mbylljen e drejtimeve, profileve, specialiteteve në shkollat profesionale dhe në qendrat e formimit profesional, si dhe hapjen e shkollave ose qendrave të reja, në përputhje me nevojat e punësimit dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

b) marrin pjesë në procesin e hartimit të standardeve kombëtare të arsimit dhe të formimit profesional;

c) organizojnë kurse formimi profesional sipas nevojave specifike të fushave që ata mbulojnë.

ç) marrin pjesë në komisionet e provimeve në përputhje me normat dhe procedurat e vendosura me akte nënligjore të ministrive të përkatëse;

d) ndihmojnë në zhvillimin e praktikave profesionale të nxënësve dhe të kursantëve.

dh) marrin pjesë në zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të politikave për reformat në AFP.

e) përfaqësues të tyre marrin pjesë në bordet e shkollave

KREUVI

STANDARDET DHE KURRIKULAT

Neni 26

Lista kombëtare e profesioneve dhe lista kombëtare e kualifikimeve profesionale miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të rekomandimeve të AKAFPK-së dhe në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe partnerët socialë.

KREUV

FINANCIMI I SISTEMIT TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

Neni 27

Burimet e financimit

Arsimi dhe formimi profesional publik financohet nga Buxheti i Shtetit, buxheti i pushtetit vendor, programet kombëtare dhe ndërkombëtare për arsimin dhe formimin profesional, kontributet e shoqatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, kontributet e dhuruesve, sponsorizimet dhe burime të tjera të lejuara nga ligji.

Neni 28

Vetëfinancimi

1. Institucionet ofruese publike të arsimit dhe formimit profesional mund të kryejnë edhe veprimtari ekonomike me përfitime financiare në fushat që kanë lidhje me zbatimin e programeve dhe të praktikave mësimore. Format dhe mënyrat e organizimit të veprimtarive ekonomike të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional veprojnë si njësi ekonomike, me llogari më vete. Për realizimin e veprimtarive prodhuese dhe të shërbimeve, ato kontraktojnë persona, fizikë dhe juridikë, me kusht që këto veprimtari të jenë në përputhje me qëllimin e institucionit për realizimin e programeve të arsimit dhe formimit profesional dhe të mos përbëjnë qëllim në vetvete.

KREUVI

Neni 29

Nxjerrja e Akteve nënligjore

Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që të nxjerrin aktet nënligjore në fushën e arsimit dhe formimit profesional, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYETARI

JOZEFINA TOPALLI (ÇOBA)

Donacioni i Çmimit te AOb, Leon van Gelder, per dy shkollat e Korçes

Qe prej me shume se 10 vjetesh, dy sindikatat tona te arsimit, FSASH dhe SPASH, bashkepunojne ngushte me Sindikaten e Arsimit te Holandes, AOb,

jepet ky Cmim i rendesishem, per persona, grupe ose insitucione, qe jane dalluar dhe kane nje kontribut te rendesishem ne fushen e reformave ne sistemin arsimor.

maksimalisht rolin e mesueit ne kete proces.

Befasuese ne kete Kongres dhe ne momentin e dhenies se ketij Cmimi, ishte fakti qe Presidenti i AOb, Walter Dresscher, beri te ditur se, duke vleresuar punen qe kane bere dhe jane duke vazhduar te bejne dy sindikatat tona te arsimit, ne shkalle vendi dhe, keto kohet e fundit, ne disa shkolla te qytetit te Korces, fituesi i cmimit Andreas Schleicher, ka vendosur qe kete Cmim, ta vere ne dispozicion te sindikatave shqiptare FSASH dhe SPASH, per te mbeshtetur punen qe ato jane duke bere ne dy shkollat e Korces, "Nuci Naci" dhe "Ismail Qemali".

Vlera monetare e Cmimit ishte simbolike, 1 000 Euro, por per te gjithet ne eshte nje vleresim shume i madh i kesaj pune qe FSASH dhe SPASH jane duke bere jo vetem ne Korce, por edhe ne shume rrethe te tjera, si edhe nje inkurajim i madh nga ana e te gjithet pjesemarrsesve ne kete Kongres te rendesishem, ku merrnin pjese edhe perfaqesues nga shume organizata te tjera ne nivel europian. Duke dashur ta bejme sa me efektive kete mbeshtetjeje, per realizimin e objektivave te Projektit tone, ne menduam qe ta veme shumen e Cmimit ne dispozicion te 14 familjeve te nxenesve qe kane braktisur

perfaqesues te se ciles kane qene disa here ne vendin tone, dhe kane mbeshtetur fuqimisht konsolidimin e sindikatave tona e sidomos angazhimin e tyre per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Ne fund te shtatorit te vitit 2012, drejtuesit kryesore te FSASH dhe SPASH moren pjese ne Kongresin e Zakonshem Kombetar te kesaj sindikate, i cili zhvillohet nje here ne tre vjete. Ceshtja e profesionalizmit te mesuesve ishte sivejt tema qendrore e Kongresit, ku u diskutuan gjeresisht probemet qe lidhen me kete teme, bazuar ne nje studim realizuar nga nje Agjensi e posacme qe merrej me kualifikimin dhe specializimin e mesuesve ne Holande.

Nje moment i rendesishem i Kongresit ishte dhenia e Cmimit **Leon van Gelder**.

Ky cmim i dedikohet njerit prej novatoreve me te medhenje te arsimit ne Holande, profesorit te Universitetit te Groningen-it, qyteti me i madh dhe me i rendesishem ne Holanden veriore, Leon van Gelder, i cili ka jetuar ne periudhen 1913 – 1981 dhe u be i famshem ne Holande me studimin mbi "Format e reja te arsimit", i cili u be dokumenti kryesor mbi bazen e te cilit eshte zhvilluar shkolla holandeze.

Ne kujtim te ketij angazhimi, qe nga viti 1985, cdo tre vjete, ne Kongresin e AOb,

Sivjet, Juria, e perbere nga autoritete te shquara te fushes se arsimit dhe te shkences ne Holande, perzgjodhi fitues, Keshilltarin Special te Sekretarit te Pergjithshem te Organizates per Bashkepunimin Ekonomik



dhe Zhvillimin, OECD, Andreas Schleicher, i cili eshte edhe Zv/Drejtor per Arsimin prane kesaj Organizate.

Juria argumentoi se fituesi i ketij Cmimi, Andreas Schleicher, si specialist dhe ne poziten e njerit prej drejtuesve te OECD, ka nje kontribut te jashtezakonshem per zhvillimin e arsimit ne Holande, ne Europe, e me gjere, bazuar sidomos ne grumbullimin dhe analizen e te dhenave, si nje baze e sigurte per inovacionin ne fushen e arsimit.

Me percaktimin: "Mesimdhenia e mire eshte zemra e arsimit", ai vlereson

shkollen, por qe permtojne qe do te rikthehen ne shkollat, duke u dhene atyre nga nje pako ushqimore me pese ushqimet baze per cdo muaj, gjate nje periudhe kohore prej per 5-6 muajore deri ne perfundim te ketij viti shkollor.

Kjo do te jete nje mbeshtetje e madhe edhe e punes qe FSASH e SPASH dhe kolektivat mesues-nxenes te ketyre dy shkollave, jane duke bere per mbajtjen e te gjithet nxenesve ne shkollat.

Stavri Liko
Sekretar i Pergjithshem i FSASH



TRIBUNA SINDIKALE

